



LAURA SHUMKA

PROF. ASOC. DR.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I KARRIERËS

Prof. Asoc. Dr. Laura Shumka është koordinatore në departamentin e Arkitekturës në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative

FUSHA E EKSPERTIZËS KËRKIMORE

- Arkitekturë/Urbanistikë
- Restaurim

EMAIL

arch.co@umb.edu.al

BIO

Laura Shumka është Professore e Asociuar, personel akademik me kohë të plotë dhe Koordinatore pranë Departamentit të Arkitekturës dhe Dizajnit në Universitetin Barleti, Tiranë. Nga viti 2020 deri në vitin 2023 ka qenë Përgjegjëse e Departamentit të Artit dhe Dizajnit në Albanian University, Tiranë. Në maj 2018, për një periudhë dy javore ka qenë lektore e ftuar në Fakultetin e Arkitekturës, Selçuk University, Konya, Turkey.

Studimet e saj universitare i ka përfunduar në vitin 1991 në Universitetin e Tiranës (sot UPT), Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, në Degën e Arkitekturës/Urbanistikës. Laura ka kryer kualifikime shkencore në fushën e ruajtjes dhe restaurimit të monumenteve të kulturës, afreskeve murale dhe ikonave, pranë Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, Shkup, Maqedonia e Veriut (1993-1995).

Ka përvojë kërkimore dhe shkencore brenda dhe jashtë vendit, në fushat e arkitekturës së objekteve të kultit, konservimit të afreskeve murale, vlerësimit të faktorëve degradues të monumenteve kulturore dhe aplikimit të standarteve të konservimit me metoda joinvazive, duke vlerësuar në mënyrë aktive studimin e peizazhit, konektivitetin dhe gjithashtu konservimin e tij. Përveç kësaj, duke bashkëpunuar në mënyrë aktive me studiues në disa disiplina të tjera të shkencës inxhinierike dhe ruajtjes së natyrës ka dhënë kontribute të shumta në shpalljen e siteve të trashëgimisë botërore të UNESCO-s (siti i Liqenit të Ohrit) ose zona të tjera të mbrojtura.

Ka qenë dhe është pjesëtar i grupeve të punës së mbi 4 projekteve kërkimore në fushat e mësipërme. Botuar mbi 20 artikuj shkencorë në revista ndërkombëtare (9 botime në revista shkencore me faktor impakti Thomson Reuters/Scopus/JCR), Anëtar Bordi Shkencor dhe Organizativ në shumë Konferenca Kombëtare e Ndërkombëtare, Revistave dhe ka realizuar vlerësime të artikujve shkencorë.